

**Anketë për pritjet inflacioniste dhe pritjet për lëvizjen e PBB-së reale****- mars 2025 -**

Anketa për pritjet inflacioniste dhe pritjet për lëvizjen reale të PBB-së<sup>1</sup> për periudhën 2025 – 2027, e kryer në muajin mars <sup>2</sup>, tregon rishikim në rënie të pritjeve, dhe atë në drejtim të ngadalësimit të normës mesatare të inflacionit, si dhe korrigjime të vogla rënëse në pritjet për rritjen e PBB-së. Analistët ekonomikë ende mendojnë se egziston shkallë e lartë pasigurie për rrjedhën e zhvillimeve të ardhshme, me theks të veçantë në rritjen e pasigurisë rreth politikave tregtare dhe zhvillimeve në ekonominë e partnerëve tanë kryesorë tregtarë. Megjithatë, nuk presin që ngjarje të tilla të kenë efekt afatgjatë, kështu, me ç'ka edhe në këtë anketë mbahen edhe pritjet për stabilizim gradual të normës së inflacionit dhe përshejtim të aktivitetit ekonomik në periudhën afatmesme.


Sa i përket **inflacionit**, të anketuarit edhe më tej presin ngadalësim dhe stabilizim gradual në periudhën afatmesme. Megjithatë, rruga e ngadalësimit të pritshëm të shprehur në këtë anketim është më e moderuar. Kështu, për vitin 2025 ata presin normë mesatare të inflacionit prej 3,7% (3% në anketën e mëparshme), e cila do të ulet në 3,1% në vitin 2026 (2,5% në anketën e mëparshme). Në afat të mesëm, për vitin 2027, të anketuarit presin që norma mesatare e inflacionit të stabilizohet dhe të ulet në 2,7%. Si faktor që mund të shkaktojë presione rritëse mbi inflacionin, të anketuarit theksojnë veçanërisht rritjen e pasigurisë rreth politikave tregtare, të cilat mund të reflektojnë në rritjen e mëtejshme të barrierave tregtare, si dhe ndërprerjen e zinxhirëve të furnizimit. Ndërkaq, ende vazhdojnë të nënvizojnë kohëzgjatjen e zgjatur dhe pasigurinë rreth zgjidhjes së luftës në Ukrainë dhe ndryshimeve klimatike, të cilat ndikojnë në çmimet e produkteve parësore, veçanërisht çmimet e ushqimeve dhe energjisë. Në të njëjtin drejtim prihen edhe rritjet e mundshme të pagave dhe pensione, si faktor i brendshëm. Nga ana tjetër, si faktorë që mund të çojnë në norma më të ulëta të inflacionit, të anketuarit listuan inflacionin e huaj më të ulët, stabilizimin gradual të çmimeve të ushqimeve dhe energjentëve, si dhe masat e ndërmarra nga politikëbërësit.

Në funksion të **aktivitetit ekonomik**, të anketuarit edhe më tej presin që rritja të përshejtohet në periudhën afatmesme, por me pritshmëri pak më të moderuara për intensitetin e rritjes. Kështu, të anketuarit presin rritje ekonomike prej 3,1% këtë vit (3,3% në anketën e mëparshme), dhe 3,5% për vitin 2026 (3,7% në anketën e mëparshme). Për vitin 2027 pritjet që rritja të përshejtohet dhe të arrijë 3,8%. Të anketuarit besojnë se ngadalësimi gradual dhe stabilizimi i inflacionit, normalizimi gradual të kushteve financiare, si dhe rritja e pagave dhe pensione mund të kontribuojë në rritjen e konsumit personal, të cilat do të kishin ndikim pozitiv në rritjen ekonomike. Gjithashtu, të anketuarit presin rritje të investimeve të huaja dhe vendase, përshejtim të zbatimit të projekteve të investimeve publike, të lidhura kryesisht me infrastrukturën rrugore dhe sektorin energjetik, si dhe investimet private, të cilat do të mbështeteshin edhe nga kreditë e shpallura për kompanitë

<sup>1</sup> Në vitin 2017, Banka Popullore bëri ndryshim në hulumtimin e anketës "Anketa për pritjet inflacioniste", që është zbatuar në "Anketa për pritjet inflacioniste dhe pritjet për lëvizjen e PBB-së reale", struktura e re së cilës e monitoron pyetësorin tremujor për parashikuesit profesional (Quarterly Survey of Professional Forecasters, [https://www.ecb.europa.eu/stats/ecb\\_surveys/survey\\_of\\_professional\\_forecasters/html/index.en.html](https://www.ecb.europa.eu/stats/ecb_surveys/survey_of_professional_forecasters/html/index.en.html)), që e zbaton Banka Qendrore Europiane (BQE) dhe njëkohësisht e ndryshoi edhe strukturën e mostrës, që tani është i përbërë vetëm nga ekspertët ekonomik.




<sup>2</sup> Anketa u zbatua në periudhën prej 11 deri 18 mars 2025.

me kushte më të favorshme. Në raport me rreziqet, të anketuarit theksojnë kryesisht pasigurinë e shtuar të politikave tregtare dhe perspektivat e përkeqësimit të rritjes së ekonomive të partnerëve kryesorë tregtarë, veçanërisht Gjermanisë, pasiguria e rrjedhës së ardhshme të luftës në Ukrainë, si dhe ndryshimet klimatike dhe ndikimi i tij në zinxhirët e furnizimit. Gjithashtu, të anketuarit përmendin zhvillimet në tregun e punës dhe emigracionin, si dhe pasiguria lidhur me rrjedhën e negociatave me BE-në si faktorë potencialë që kufizojnë rritjen ekonomike në periudhën e ardhshme.






Në kuadër të Anketës, të anketuarit japin edhe mendimin e tyre për **shpërndarjen e probabilitetit për realizimin e normave të përcaktuara në interval të caktuar**. Këto vlerësime përdoren për krijimin e shpërndarjes agregate të probabiliteteve<sup>3</sup>. Shpërndarja agregate e probabiliteteve për realizimin e normave të dhëna të inflacionit dhe PBB-së në pesëmbëdhjetë intervale është shfaqur në grafikonët në vijim, dhe rezultatet kryesisht janë në pajtim me normat që të anketuarit i presin.

<sup>3</sup>Shpërndarja agregate e probabiliteteve paraqet mesatare nga vlerësimet e të anketuarve për probabilitetet, për çdo interval të normës së pritur të inflacionit dhe normës së rritjes së PBB-së.



Në raport të **normës së inflacionit**, shpërndarjet e probabilitetit për këtë dhe dy vitet e ardhshme tregojnë për zhvendosje drejt intervaleve më të ulëta dhe përqendrimit më të madh në dhe rreth intervaleve të pritshme të normës mesatare.



Kur bëhet fjalë për **normën e pritshme të PBB-së**, shpërndarja e probabilitetit për këtë dhe për vitin e ardhshëm tregon për përqëndrim më të lartë në dhe rreth normës mesataretë pritur.